



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dituruar Punë/Procedurë Review/Decision	31.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Dr. Prof. Pr. Prof. Prof. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKMESHOK	3245/2023		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.331/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.331/2023 të datës 07.02.2023 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ me adresë pune \_\_\_\_\_ kundër Vendimit me numër XII-09 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit i datës 10.01.2023, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Anullohet Vendimi me numër XII-09 i datës 10.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit, ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* tek Komisioni Disiplinor.
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja \_\_\_\_\_ e cili sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Komunën e Obiliqit, me datë 07.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil e cila është regjistruar me shenjen A.nr.331/2023 dhe numër protokolli:1504/2023, kundër Vendimit me numër XII-09 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit i datës 10.01.2023.



Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisionin Disiplinor me rastin e shqiptimi të masës disiplinore, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar, ndërsa të anulojë vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 10.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 15.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa me datën 20.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Më Vendimin me numër protokollit 2822/2023 të datës 20.03.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës A.nr.331/2023 të datës 07.02.2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave për shqyrtimin e kësaj ankese administroi këto prova:** Ankesën me numër te protokollit 1504/2023 të datës 07.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vendimi i lëshuar nga Komisioni Disiplinor me numër XII-09 i datës 10.01.2023; kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 07.12.2022; Shkresën e datës 06.02.2023 dërguar nga ankuesja për ASHI; E-mailin e datës 06.02.2023 dërguar nga ankuesja për ASHI; E-mailin e datës 08.02.2023 dërguar nga ankuesja për ASHI me listën e bashkangjitur; Njoftimin e datës 10.02.2023 dërguar nga Prokurimi Obiliq për KRPP-në; Njoftimin e datës 10.02.2023 dërguar nga Prokurimi Obiliq për Agribau SHPK me korrespondencën e bashkangjitur; kërkesën e datës 10.05.2023 dërguar nga Prokurim Obiliqi për Rregullat KRPP; Kërkesën për interpretim të datës 10.05.2022 dërguar nga ankuesja për KRPP me shifër:XIII-343; Përgjigjen e datës 11.10.2022; Kërkesën e datës 19.10.2022 dërguar nga Prokurimi Obiliq për OSHP; E-mailin e datës 19.10.2022 dërguar nga Kryetari i Komunës së Obiliqit për OSHP-në; Kërkesën e datës 25.10.2022 dërguar nga për ; Kërkesën e datës 05.05.2022; Njoftimi për informatën shtesë e datës 31.03.2022 me dy (2) fatura përcjellëse; E-mailin e datës 01.09.2022 dërguar nga për ankuesen; Njoftimin e datës 26.08.2022 dërguar nga Prokurimi Obiliq për AKK hetimet; Raportin e Ekspertit Shqyrtues i datës 03.08.2022; E-mailin e datës 22.08.2022 dërguar nga ankuesja për ; Vendimin .nr.281/22 të datës 16.08.2022 lëshuar nga OSHP; Kërkesën e datës 16.08.2023 dërguar nga ankuesja për Kryetarin e Komunës së Obiliqit; Vendimin e datës 15.08.2022 lëshuar nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit të komunës së Obiliqit; Vendimin e datës 16.08.2022 të Kryetarit të Komunës; Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 23.09.2022; Letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm i datës 23.09.2022 me Nr. prokurimit OB614-22-533-2-2-1; Letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm i datës 23.09.2022; Përgjigjen e datës 04.10.2022; Çertifikatën e datës 24.06.2022 lëshuar nga Gjykatat themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike; Çertifikatën e datës 30.06.2022 lëshuar nga Gjykatat Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë; E-mailin e datës 21.09.2022 dërguar nga ankuesja për Adem Tushaj; E-mailin e datës 19.08.2022 dërguar nga për Raportin e Ekspertit Shqyrtues i datës 11.11.2022; Vendimin PSh.nr.534/2022 i datës 07.12.2022 lëshuar nga OSHP; E-mailin e datës 14.10.2022 dërguar nga ankuesja për , E-mailin e datës 21.10.2022 dërguar nga për ankuesen; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Akt emërimit e ankueses i datës 07.05.2014; Akt emërimit e ankueses i datës 07.05.2015; Akt emërimit e ankueses i datës 01.06.2015; Autorizimin e datës 24.01.2022; vendimin e datës 28.06.2022 lëshuar nga Kryetari i Komunës; Vendimin e Këshillit A.nr.633/2022 të datës 22.09.2022; Kërkesat për pushim; Fletë lëshimi dhe epikrizë e datës 11.08.2022 lëshuar nga Qendra Klinike Universitare Prishtinë-Klinika Obstetrike Gjinekologjike; E-mailin e datës 22.08.2022 dërguar nga për Shenjat e





pushimit mjekësor; Raportin Mjekësor i datës 08.07.2022; Raporti Histopatologjik/Citologjik i datës 05.09.2022; E-mailin e datës 18.10.2022 dërguar nga kryetari i Komunës për ankuesen; Dorëheqjen e datës 18.10.2022 parashtruar nga ankuesja; E-mailin e datës 20.10.2022 dërguar nga për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të datës 07.12.2022; Kërkesën për Përgjigje në ankesë të datës 25.02.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.03.2023; Akt emërimit të ankueses të datës 01.06.2015; Autorizimin e datës 21.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën zyrtar i lartë i prokurimit; E-mailin e datës 09.12.2022 përcjellë nga për anëtarët e Komisionit Disiplinor; Njoftimin e datës 09.12.2022 dërguar nga për ankuesen; E-mailin e datës 16.12.2022 dërguar nga për ankuesen; Përgjigjen e kryetarit të Komunës së Obiliqit të datës 16.11.2022; Raporti i Ekspertit Shqyrtues i datës 11.11.2022 me numër lëndë:534/22; E-mailin e datës 19.10.2022 dërguar nga OSHP për Kryetarin e Komunës; Përgjigjen e datës 11.10.2022 dërguar nga KRPP për Komunën e Obiliqit; Kërkesë për interpretim e datës 10.05.2022 dërguar nga Komuna e Obiliqit për KRPP; Kërkesën e datës 05.10.2022 me shifër XIII-343;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 01.06.2015 mban pozitën e punës “Zyrtar i Lartë i Prokurimit” në kuadër të Komunës së Obiliqit, ndërsa Kryetari i Komunës së Obiliqit me datë 21.04.2022 përmes autorizimit me shifër: II/381 e ka ngarkuar të njëjtën që t’i kryej detyrat dhe përgjegjësit e Menaxheres së Prokurimit dhe atë duke filluar nga data 21.04.2022 e deri në momentin e zgjedhjes së Menaxherit të Prokurimit. Ndërsa në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë ndaj të ankueses përmes kërkesës së datës 09.12.2022, ka kërkuar inicimin procedurës disiplinore për shkelje disiplinore dhe atë për mos përmbushjen apo shkeljen e detyrave të punës në katër (4) raste, me arsyetim se ë njëjta ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës sipas nenit 46 paragrafi 2.1 dhe 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Tutje pas shqyrtimit të lëndës, Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër XII-09 të datës 10.01.2023, kishte konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të përcaktuara me nenin 45 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe si rrjedhojë të njëjtës i ka shqiptuar masën disiplinore “Ndalim nga 20% të pagës për periudhën kohore prej katër (4) muaj” me arsyetimin se ankuesja është përgjegjës për tre (3) rastet si në vijim: (1. KRPP-Prokurimi Obiliq, 2. OSHP-Prokurimi Obiliq, dhe APK Prokurimi Obiliq) nga gjithsejtë katër (4) rastet e paraqitura si shkelje të rënda e detyrave të punës me rastin e inicimit të procedurës disiplinore nga Kryetari i Komunës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ndërlidhur me arsyetimin e vendimmarrjes nga ana e Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 45 dhe të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit” si dhe nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 i të njëjtit ligj që përcakton se: “1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; dhe 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. Mos përmbushja e detyrave të punës, dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të jetë bindës në



arsyetimin e bërë në Vendimin me numër XII-09 të datës 10.01.2023, përmes të cilit ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës për periudhën kohore prej katër (4) muaj", ngase nuk ka arritur të konstatoj saktë se cila është pasoja dhe dëmi i shkaktuar që ndërlidhen me veprimin apo mos veprimin e ankueses, nëse dëmi është shkaktuar nga veprimi me faj apo si pasojë e mos veprimit, sikurse nuk ka arritur të konstatojë se cila është lidhja shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, ngase në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit elementet e përgjegjësive disiplinore duhet të kenë lidhje komulative ndërmjet vete si tërësi, kurse në rastin konkret Komisioni Disiplinor vetëm i është referuar nenit 45 të ligjit material në preambulën dhe përfundimin e vendimit të kontestuar, pas specifikuar dhe arsyetuar se në cilin moment apo veprim janë konsumuar elementet e përgjegjësive disiplinore e të cilat duhet të këndë ndërlidhje komulative mes vete.

Po ashtu, nga shqyrtimi i përmbajtës së vendimit të kontestuar, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor ngase arsyetimi i dhënë nuk ka arritur të qartësojë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret si dhe nuk ka pasqyruar shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palës ankuese sikurse përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, prandaj në mbështetje të nenit 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-131 të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se "Një arsyetim që është dukshëm i panjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", prandaj në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: " 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", Kolegji i këshillit konstatoi se Vendimi me numër XII-09 i datës 10.01.2023 i Komisionit Disiplinor është akt administrativ i paligjshëm dhe si i tillë është anuluar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa lënda e ankueses kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit, ngase në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit për shkak të paligjshmërisë së aktit të kontestuar dhe mungesës së arsyetimit lidhur me vërejtjet e dhëna si më lartë, Kolegji nuk ka mundur të verifikoj dhe konstatoi faktin nëse ankuesja ka kryer apo jo shkelje të rënda të detyrave të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e ligjit material.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Komisioni Disiplinor i Komunës me rastin e rishqyrtimit të dhe rivendosjes së lëndës disiplinore të ankueses duhet të ketë parasysh vërejtjet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi dhe duhet të shqyrtojë pretendimet e ankueses e cila në provat e bashkangjitura me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka ofruar dëshmi nga ASHI lidhur me validitetin e e-mailit zyrtar KRPP MALL që ndërlidhet me pikë një (1) të inicimit të procedurës disiplinore sipas të cilës ankuesja është gjetur përgjegjëse, po ashtu ndërlidhur edhe me pikën dy (2)-mungesën e dërgesës së përgjigjes apo vonesës sipas kërkesës së OSHP lidhur me provat e kërkuara duhet ta keni parasysh e-mailin e datës 17.10.2022 dërguar nga OSHP për Prokurim Obiliq, e që në përmbajtje e të cilës nuk është paraqitur ndonjë afat specifik brenda të cilës ankuesja ka qenë e obliguar të kthejë përgjigje OSHP-së, sikurse duhet të merrni parasysh se lidhur me pikë tre (3) duhet të keni mendim nga njohësit e fushës apo t'i drejtoheni institucioneve përgjegjëse me kërkesën për sqarim së nën përgjegjësi të kujt janë përcaktimi specifikave teknike të tenderit, ngase norma të cilës i është referuar Komisioni Disiplinor, respektivisht nenit 11 pika d të Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik specifikohet se: "Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në



*pajtim me dispozitat e LPP. ZPP përveç obligimeve tjera ka përgjegjësitë në vijim: Për aq sa mundet, siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë” pasi që shprehja e përdorur “Për aq sa mundet” nuk e përkufizon të gjithë përgjegjësin mbi menaxherin e prokurimit në rastin konkret.*

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ekzistojnë arsytet të mjaftueshme që lënda e ankueses të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor me qëllim që i njëjti gjatë rishqyrtimit të lëndës të arrijë te konstatimet e sakta duke pasur për bazë dhe respektuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe akteve nën ligjore që rrjedhin prej tij që ndërlidhen me fushën e përgjegjësisë disiplinore, sikurse institucioni punëdhënës gjegjësisht Njësia përgjegjëse për menaxhimin e Burimeve Njerëzore duhet të ketë parasysh dispozitat e nenit 130 paragrafi 1 dhe nenit 144 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërlidhur me ekzekutueshmërinë e aktit të kontestuar.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.331/2023

Flakron Gashi

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

Malsore GASHI BAJRAJTARI

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetari të Komunës së Komunën e Obiliqit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.